



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. 4310 prot.

Ballsh më, 20 / 08 / 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 45 Datë 20 / 08 / 2026

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT ME OBJEKT: RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE NË QYTETIN BALLSH, BASHKIA MALLAKASTËR

Mbështetur në nenin 9, pika 1.2, shkronja "b", të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen e në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, VKB-së nr.52, datë 23.12.2025 "Për miratimin e financimeve të ndarë në 3-vite" si dhe projektit të hartuar nga ana e Bashkisë Mallakastër,

PROPOZOJ

I. Miratimin e projektit "Rikonstruksioni i rrugëve në qytetin Ballsh, Bashkia Mallakastër, si më poshtë:

- 1.1. Rrugët e brendshme të lagjes "5 Shkurti" (pas Postës)
- 1.2. Rrugët e brendshme të lagjes "Gllavenica" (poshtë Hekurudhës)

II. Miratimin në parim për shpronësimin / zhdëmtimin e pronave që mund të preken nga zbatimi i projektit.

III. Ky projekt -vendim shoqërohet me relacion shpjegues.

Konceptoi: Juristi A.Heqimaj
Pranoi : Përgj. N.Sakaj
Miratoi: Drejtor M.Shehaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE PROJEKTEVE

Nr. 4310/11 prot.

Ballsh, më 20.08. 2026

RELACION: PËR PROJEKTIN “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE NË QYTETIN BALLSH”

Mbështetur në nenin 9, pika 1.2, shkronja “b”, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen e në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Mallakastër Nr. 52, datë 23.12.2025 “Për miratimin e financimit të ndarë në 3-vite”, nga ana e Bashkisë Mallakastër është hartuar projekti me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve në qytetin Ballsh”.

Hartimi i këtij projekti vjen si pasojë e nevojës së ndërhyrjeve në infrastrukturë rrugore, për shkak të amortizimit të rrugës ekzistuese.

Projekti i këtij objekti përfshin segmentet si vijon:

- 1.1. Rrugët e brendshme të lagjes “5 Shkurti” (pas Postës)
- 1.2. Rrugët e brendshme të lagjes “Gllavenica” (poshtë hekurudhës)

Realizimi i projektit për rikonstruksionin e këtyre segmenteve rrugore do të bëhet shtresë çakëlli, stabilizanti, binderi dhe asfalti. Gjithashtu për rikonstruksionin e tyre nevojiten edhe punime veprash arti si tombino si dhe punime sinjalistike si vijëzime dhe tabela.

- 1- Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të lagjes “5 Shkurti” (pas Postës), përfshinë segmentin sipas detajit të paraqitur në figurën nr.1. Segmenti i rikonstruktuar ka gjerësi të ndryshme sipas konfiguracionit të terrenit.



Fig.1 Planvendosja e rrugëve të brendshme të lagjes “5 Shkurti” (pas Postës)

- 2- Rikonstruksioni i rrugësve të brendshme të lagjes “Gllavenica” (poshtë hekurudhës), përfshin segmentin sipas detajit të paraqitur në figurën nr.2. Segmenti i rikonstruktuar ka gjerësi të ndryshme sipas konfiguracionit të terrenit.



Fig.2 Planvendosja e rrugëve të brendshme të lagjes “Gllavenica” (poshtë hekurudhës)

KRYETAR

Qerim Ismailaj

